

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1088/prot.

3

Urë Vajgurore, më 30.04.2024

VENDIM

Nr. 26 Datë 30.04.2024

“Konkluzionet e Inventarizimit të Aktiveve për vitin 2023”

Këshilli i Bashkisë Dimal, në mbledhjen e tij të datës 30.04.2024 mbi bazën e materialit të paraqitur nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” nën 6 gërma (e) e ligjit Nr 10296 datë 08/07/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, si dhe në udhëzimin e Ministrit të financave Nr 30 datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik”, mbështetur në relacionin e vleresimit të aktiveve dhe proces-verbalin e mbajtur nga komisioni për nxjerjen jashtë përdorimit.

VENDOSI :

Me 17 vota PRO, nga 17 Këshilltarë prezentë:

1. Të miratojë shumën 610,182 lekë aktive afatshkurtëra materiale konsumi lekë inventari i imët llogaria 327 në masën 610,182 lekë, jashtë përdorimit për shkak se kanë plotësuar afatin e përdorimit, riparimi i tyre në pjesën më të madhe të tyre është i pamundur si pasojë e konsumit të dëmtimit në shkallë që kanë humbur cilësinë e tyre, janë të papërdorshme si pasojë e konsumit të tyre.
2. Të miratojë Shumën 5,689,092 lekë Aktive afatgjata, jashtë përdorimit për shkak se kanë plotësuar afatin e përdorimit. Riparimi i tyre në pjesën më të madhe të tyre është i pamundur si pasojë e konsumit të dëmtimit në shkallë që kanë humbur cilësinë e tyre, janë të papërdorshme si pasojë e konsumit të lartë të tyre. (Nga këto 2,272,812 janë inventar ekonomik llogaria 218 , dhe 3,416,280 lekë llogaria 214 janë makineri e paisje pune) .

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak të publikojë vendimin në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak Dimal.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të Ligjit 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore “, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

AVDULLA SALILLARI

